



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 23, dt. 01.02.2017

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim KKR nr. 75, date 03.04.2015 “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, në mbledhjen e dt. 01.02.2017 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për dhënie license në fushën e restaurimit për Shoqërinë “MANE/S” shpk, me drejtues teknik ing. Bledar Mane (RP 72),

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Shoqërisë “MANE/S” shpk me drejtues ligjor Z. Bledar Mane për pajisje me licensë restaurimi për kategorinë:
“CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik ing. Bledar Mane (R.P 72).
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licensë restaurimi për Shoqërinë “MANE/S” shpk, për kategoritë:
“CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik ing. Bledar Mane (R.P 72).
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

ARTA DOLLANI